



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit komunal të mbajtur me dt.30.12.2025, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Albanë Shillova Shalaku (LVV), Arbenita Pllana (LVV), Bardhyl Mjekiçi (LVV), Burim Ismaili (LVV), Fitim Grajçevci (LVV), Fjolla Nasufi (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Mervete Shala (LVV), Sami Ahmeti (LVV), Abdylrahman Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Enver Gashi (LDK), Fidan Ahmeti (LDK), Fitore Hashani (LDK), Labinot Mirena (LDK), Linda Bekteshi (LDK), Muhamet Preniqi (LDK), Vlora Mjekiçi Kabashi (LDK), Biljana Spasic (SL), Goran Dancetovic (SL) dhe Dorentina Mustafa (AAK).

Të pranishmit tjerë: Kryetari i Komunës, Halil Thaqi, Berat Gashi, Nënkyetar i Komunës, drejtorët komunal, përf. e KFOR-it, përf. e OSBE-së dhe zyrtarët komunal.

Mbledhjen e udhëhoqi Sami Ahmeti, kryesues i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloimbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Formimi i Grupit punues për hartimin e Planit të Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2026
4. Shqyrtimi dhe Miratimi i Listës së Përgjithshme të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Listës së Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim
5. Shqyrtimi i Raportit të Zbatimit të Planit të Integritetit
6. Formimi i Komitetit për Politikë dhe Financa
7. Formimi i Komitetit për komunitete
8. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionareve të N.P.L. "Kastrioti" SH.A.
9. Të ndryshme

Kryesuesi – Hapi mbledhjen dhe ftoi 2 anëtarët e rinjë të Kuvendit Komunal, z.Burim Ismaili (LVV) dhe znj, Arbenita Pllana (LVV) të japin betimin të cilët edhe e dhanë betimin për anëtarë të Kuvendit Komunal. Pastaj, kryesuesi i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 21 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara me 19 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2026. Ky është një plan që bëhet në secilin vit paraprak për vitin vijues dhe ky grup punues mund ti ketë 3 anëtarë, por me kërkesën tuaj mund ti ketë edhe më tepër.

Fjolla Nasufi – Propozon znj.Lendita Krasniqi për anëtare të grupit punues.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit Komunal të Obiliqit, nr.-I-95 të dt.29.06.2018, konkretisht nën 64 pika 5, ju njoftoj se grupi i anëtarëve të LDK-së, përfaqësohet nga unë Vlora Mjekiqi Kabashi. Sa i përket formimit të grupit punues për hartimin e Planit të punës të Kuvendit Komunal për vitin 2026, unë propozoj veten Vlora Mjekiqi Kabashi.

Fjolla Nasufi – Propozon z.Burim Ismaili, për anëtar të Grupit Punues.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota për morën Vendim për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të punës të Kuvendit Komunal për vitin 2026 me këtë përbërje: 1.Lendita Krasniqi, 2.Vlora Mjekiqi Kabashi dhe 3.Burim Ismaili.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin dhe Miratimin e Listës së Përgjithshme të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Listës së Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim aftagjatë për vitin vijues 2026.

Fjolla Nasufi – Duke pasë parasysh se ky është një proces i përvitshëm, ne jemi për.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Ne jemi për atë që kjo listë të miratohet sepse ashtu siç është paraparë edhe me ligj, por nëse ka mundësi me një rekomandim të vogël ku në shkresë thuhet Komisioni komunal, që zakonisht e kemi edhe nga e kaluara, ku ju vetë keni kërkuar sepse e din që Komuna ka me mijëra Komisione. Prandaj, është mirë herën tjetër kur thuhet Komisioni komunal të caktohet vendimi, numri i protokollit dhe data sepse kjo na bënë të kuptojmë prej cilës Drejtori është ky Komision dhe kur është aprovuar ky Komision, kështu që në parim jemi për.

Goran Dancetovic – Ne nuk e kemi pranuar listën e patundshmërisë si dhe procesverbalin nga mbledhja e fundit dhe për këtë shkak kemi qenë të përmbajtur nga votimi..

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 19 vota për morën Vendim për Miratimin e Listës së Përgjithshme të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Listës së Veçantë të Pronave të Paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim aftagjatë për vitin vijues 2026.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqiti shqyrtimin e Raportit të Zbatimit të Planit të Integritetit. Ky është një plan i rregullt që bëhet nga zyra për këtë çështje. Duke pasë parasysh që nuk është arritë të trajtohet mjaftueshëm ky raport nuk ka nevojë as të votohet.

Fjolla Nasufi – Aktualisht nuk kemi koment rreth kësaj pike.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Edhe ne nuk kemi si grup, edhe pse kryesues ndoshta është dashur neve së pari të na jepet fjala në bazë të numrit që kemi në Kuvend, jemi të parët ndoshta me propozime.

Kryesuesi – E nderuar znj.Vlora, lidhur me këtë çështje unë kam kërkuar edhe interpretim nga MAPL-ja. Duke pasë parasysh që kjo çështje matet me ulëse në Kuvend, është në diskrecionin tonë edhe duke pasë parasysh se unë gjithmonë anës së djathtë i japë përparësi, kështu që kësaj radhe do të shkojmë kështu.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi - Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës, Rregullores dhe Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, Komiteti për Politikë dhe Financa në Komunën tonë do të përbëhet prej 7 anëtarëve. Duke pasë parasysh se LVV-ja, ka 9 anëtarë në Kuvend përfaqësohet nga kryesuesi plus 2 anëtarë tjerë, LDK-ja përfaqësohet po ashtu me 3 anëtarë dhe mendoj se edhe AAK-ja duhet të përfaqësohet me një anëtar duke pasë parasysh se duam të kemi gjithëpërfshirje edhe në Komitetin vijues do të kenë mundësi të përfaqësohen edhe grupi i listës së rrebe.

Fjolla Nasufi – Propozon veten Fjolla Nasufin dhe Albanë Shillova Shalakun.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Në bazë të Udhëzimit Administrativ MAPL nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë,

konkretisht neni 5 pika 2 e specifikon etniteti politik me numrin më të madh të vendeve varësisht nga përqindja e përfaqësimit në Kuvend, do të përfaqësohet edhe në Komitet. Ne e dijmë shumë mirë nga e kaluara se në këto Komitete përfaqësohen anëtarët të cilët kanë grupe dhe AAK-ja, nuk është e përfaqësuar në grup sepse dihet që grupi së paku duhet ti ketë 3 anëtarë. Pra, nuk mund të përfaqësohet në Komitetin për Politikë dhe Financa sepse nuk është grup politik, është vetëm një anëtar.

Kryesuesi – Ne thamë edhe më heret se duam të kemi një gjithëpërfshirje dhe jemi dakord nëse me votat e anëtarëve të Kuvendit Komunal kalon një pikë e tillë, por cilat janë propozimet tuaja.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Propozimet e mia janë Fidan Ahmeti, Vlora Mjekiqi Kabashi, Linda Bekteshi dhe Enver Gashi.

Abdyrrahman Krasniqi – Nga LDK-ja, e propozojmë edhe një herë znj.Vlora Mjekiqi Kabashi, meqë është edhe shefe e grupit dhe po ashtu, e propozoj z.Labinot Mirena si dhe veten z.Abdyrrahman Krasniqi në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Goran Dancetovic – I nderuari kryesues, e dëgjova diskutimin tuaj nga fillimi dhe mendoj se është në kundërshtim me nenin 57 të Statutit të Komunës dhe mendoj se propozimi juaj për këtë pikë për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa është në kundërshtim me nenin 57 të Statutit të Komunes së Obilicqit. Në këtë nen theksohet se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit Komunal dhe duhet të pasqyrojnë proporcionin e përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimit gjinor të Kuvendit. Do të thotë 30 % e grave duhet të jenë nga radhët e cdo partie politike që janë të përfaqësuar në Kuvend, kështu që konsideroj se edhe Lista serbe duhet ta ketë anëtarin e vet në Komitetin për Politikë dhe Financa, e jo të grupit të anëtarëve të Kuvendit prej 3. Dëgjova diskutimin tuaj nga fillimi dhe mendoj se është në kundërshtim me nenin 57 të Statutit të Komunës sepse mendoj se propozimi juaj për këtë pikë për formimin e Komitetit për komunitete është në kundërshtim me nenin 57 të Statutit të Komunës së Obilicqit. Në këtë nen theksohet se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të zgjedhen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit Komunal si dhe duhet të pasqyrojnë proporcionin e përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimit gjinor të Kuvendit. Do të thotë 30 % e grave duhet të jenë nga radhët e cdo partie politike që janë të përfaqësuar në Kuvend, kështu që konsideroj se edhe Lista serbe duhet ta ketë anëtarin e vet në Komitetin për Politikë dhe Financa, e jo të grupit të anëtarëve të Kuvendit prej 3.

Kryesuesi - Unë thashë edhe në pikën paraprake se ne duam që secili grup i anëtarëve të Kuvendit të përfshihet ndërsa, në grupin vijues lista serbe do ta ketë përfaqësuesin e vet.

Dorentina Mustafa - Unë e propozoj veten time Dorentina Mustafa meqenëse, jam e vetmja përfaqësuese nga Aleanca në Kuvend.

Enver Gashi – Kryesues, ne si grup parlamentar dhe krejtë grupet parlamentare e kemi një shef të grupit që përfaqëson krejtë grupin. E kam një vërejtje shumë të madhe se nuk je bash i ri sepse ke qenë një mandat këtu dhe kur pyetet shefi i LVV-së, e i jepë kandidatët për mua e për Kuvend dhe për ligj e rregullë përfundon, e jo edhe një herë kujt ti teket. Njëjtë e ke edhe te LDK-ja, ne e kemi shefin dhe shefi i jepë propozimet bazuar në ligj dhe Rregullore, e tash të pyetet edhe secili anëtarë atëherë po bëjmë pazare. Mirëpo, ka rregullë dhe ka ligj, ju lutem zbatone.

Kryesuesi – Ju fillimisht keni dhënë propozime më tepër se që janë të lejuara, përveç asaj neni 70 i Rregullores së punës së Kuvendit Komunal pika 1,2,3,4 dhe 5 e sqarojnë se ka mundësi të ketë propozime edhe më tepër. Në rast se ka propozime më tepër ato votohen dhe jemi në rregullë. Gjithsesi, në fazën e parë ju keni dhënë 4 propozime dhe mendoj se njëri prej tyre duhet të tërhiqet për arsye se kjo është edhe implementim i MAPL-së, që na e kanë bërë, kështu që cili prej anëtarëve mendoni se duhet të tërhiqet.

Vlora Mjekiqi Kabashi - Atëherë, tërhiqet z.Enver Gashi.

Kryesuesi – Nga LVV-ja, janë propozuar përveç meje si kryesues edhe Fjolla Nasufi dhe Albanë Shillova Shalaku, ndërsa nga LDK-ja, janë propozuar Vlora Mjekiqi Kabashi, Fidan Ahmeti dhe Linda Bekteshi si dhe nga Aleanca Dorentina Mustafa.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal votuan për propozimin e parë me 7 vota për dhe 12 vota kundër për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi – Duke u bazuar në Rregulloren e Kuvendit Komunal neni 70 i Rregullores, shkojmë me propozimin e dytë, nga LVV-ja, a ka ndonjë ndryshim të emrave.

Fjolla Nasufi – Nuk kemi ndryshim të emrave.

Kryesuesi - Atëherë votojmë për propozimin e dytë për anëtarët nga LVV-ja, Sami Ahmeti, Fjolla Nasufi dhe Albanë Shillova Shalaku ndërsa nga LDK-ja, Vlora Mjekiqi Kabashi, Labinot Mirena dhe Abdylrahman Krasniqi si dhe nga Aleanca Dorentina Mustafa.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Kryesues, ju lutem.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal për propozimin e dytë votuan me 12 vota për, 7 vota kundër dhe 1 votë abstenim morën Vendim për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa me këtë përbërje:

1. Sami Ahmeti, Kryesues (LVV), 2. Fjolla Nasufi, anëtare (LVV), 3. Albanë Shillova Shalaku, anëtare (LVV), 4. Vlora Mjekiqi Kabashi, anëtare (LDK), 5. Labinot Mirena, anëtar (LDK), 6. Abdylrahman Krasniqi, anëtar (LDK) dhe 7. Dorentina Mustafa, anëtare (AAK).

Goran Dancetovic – Zoti kryesues edhe njëherë po paraqitem, ne të drejtat tona do t'i kërkojmë në Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, sepse konsiderojmë se e keni shkelur nenin 57.

Enver Gashi – Shefi i grupi e përfaqëson grupin dhe thashë pazaret leni se e keni shumë gabim. Lexone ligjin, me pasë ndikim një anëtar i Kuvendit për juve që keni bërë pazar me të, kjo është turp. Ne kemi me bë një ankesë të madhe se ky Kuvend publikisht transmetohet, edhe mund ta shohin edhe qytetarët me pa se çka jeni duke bërë vërtetë turp, turp mos iu paqa borxh, këtë borxh nuk mundem me ua lënë.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesi - E kemi formimin e Komitetit për komunitete dhe sipas ligjit ky Komitet përbëhet prej 9 anëtarëve, ku 3 prej tyre votohen nga Kuvendi Komunal. LVV-ja, do ta ketë një anëtar, LDK-ja, do ta ketë një anëtar dhe lista serbe një anëtar.

Fjolla Nasufi – Propozon znj.Mervete Shala, për anëtare në Komitetin për komunitete.

Vlora Mjekiqi Kabashi – I nderuari kryesues, edhe pse e dijmë shumë mirë se pika paraprake nuk ishte në rregull për shkak se si shefe e grupit unë i dhashë propozimet e mia, por me votë normal që ju e mundët. Mirëpo, sido që të jetë në Komitetin për komunitete e propozoj z.Muhamet Preniqi.

Goran Dancetovic – Propozon znj.Biljana Spasic.

Pas propozimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 21 vota për morën Vendim për formimin e Komitetit për Komunitete me këtë përbërje: 1.Mervete Shala, anëtare (LVV), 2. Muhamet Preniqi, anëtar (LDK). 3. Biljana Spasic, anëtare (SL)

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesi – E kemi formimin e Komisionit komunal të Aksionarëve të NPL."Kastrioti".

Goran Dancetovic – E thatë se Komiteti për komnitete duhet t'i ketë 9 anëtarë, ndërsa ne propozuam 3 anëtarë të Kuvendit, si është çështja e 6 anëtarëve tjerë.

Kryesuesi – Sipas ligjit pjesa tjetër e Komitetit për Komunitete do të zgjedhet sipas nenit 8 dhe 9 pika 1 e Udhëzimit Administrativ nr.05/2020 dhe konkursit për përfaqësim të komuniteteve të cilat jetojnë në Komunën e Obiliqit. Komisioni i Aksionarëve përbëhet prej 3 anëtarëve, ku një anëtar është nga Ekzekutivi dhe 2 anëtarë tjerë nga Kuvendi Komunal.

Kryetari – Propozon znj.Albertina Dedinca, anëtare të Komisionit.

Fjolla Nasufi – Propozon z.Bardhyl Mjekiqi dhe z.Labinot Mirena, anëtarë të Komisionit.

Kryesuesi – E hudhi në votim formimin e Komisionit komunal të Aksionarëve me anëtarët e propozuar.

Enver Gashi – Më shumë je duke i përkrahë 2 vetë që ke bë pazare dhe pazaret veç u panë. Tash, edhe ne jemi grup dhe duhet me na pyet dikush.

Kryetari – Më ngadalë.

Enver Gashi - Kryetar, është inçizue dhe kaloi propozimi dhe jo ngadalë por ne do të reagojmë shumë, sepse nuk jeni askund, kemi votë më shumë në Kuvend dhe mos të respektohem fare, vetëm të thuhet kush jeni për dhe u krye.

Kryetari – Nuk ka nevojë shumë me u nxehtë, si qetë po shkojmë dhe vota e qytetarit na ka sjellë këtu, votojnë asamblistët kend e votojnë këta dhe procesi ecë përpara. Ne kemi ardhë këtu, me i shtye proceset përpara dhe ka mundësi të bëhet ndonjë lëshim në procedura, që ju kërkoj falje sepse edhe unë jam fillestar në këtë vend që e kam, edhe kryesuesi është fillestar që duhet me na mirëkuptue edhe neve, me na tërheqë vërejtjen se këtu është gabim dhe e përmirësojmë. Për çdo ankesë është MAPL-ja, atje dhe mund të bëni ankesë, prandaj mos ta marrim me presion këtë punë.

Kryesuesi – E mira është se kemi ligj dhe keni mundësi të ankoheni secili që konsideron se ka ndonjë vërejtje.

Abdyrrahman Krasniqi – Unë dua ta njoftoj z.Enver se më duket pak reagimet shumë gjaknxehtë, fillimisht ne e kemi votën e qytetarëve dhe secili prej neve e kemi për obligim me i përfaqësue qytetarët, e jo shefat qysh po mendon ky e pazaret. Nëse, ky mendon dhe është mësue gjatë karrierës së vet me bë pazare dhe me e pyet në çdo kohë z.Enver, unë veç e njoftoj se sot ky është në pension, kështu që le të ketë mirëkuptim e të filloj të demokratizohet. që ti kuptoj mendimet ndryshe. Ne jemi këtu, për interes të qytetarëve, kemi bërë veprime në interes të qytetarëve dhe zhvillimit të Komunës së Obiliqit, ndërsa ky nuk ka mirëkuptim në këtë drejtim.

Enver Gashi – I nderuar, pazaret po shihen, po shihen Komitetet, po shihen aksionarët dhe ne as nuk jemi të verbër, as nuk jemi që nuk dëgjojmë, por ato që shihen nuk dojnë kallauz. Mirëpo, në krejtë demokracinë shefi i grupit për atë zgjedhet dhe nuk është vetëm shefi që e ka mendimin e vet, por mendimin e krejtë grupit dhe tash çka tjetër.

Vlora Mjekiqi Kabashi – I nderuari kryesues, ju edhe mund të kaloni me votën tuaj propozimet tuaja, por nuk mund të na mohoni të drejtën e propozimit sepse nuk ua kemi mohue as juve, kështu që kemi të drejtë propozimi dhe vendosni me votë patjetër.

Kryesuesi – Edhe para 4 viteve, njëjtë është veprue do të thotë propozimet kanë qenë vetëm nga ana e Ekzekutivit dhe sido që të jetë ju mund të bëni propozim dhe e hedhim në votim, çfarë emri keni ju për këtë ndërmarrje.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Sa i përket formimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve N.P.L. “Kastrioti” SH.A. ne propozojmë znj.Fitore Hashani.

Kryesuesi – I kemi 2 propozime, kemi propozimin për Albertina Dedincën, Bardhyl Mjekiqi dhe Labinot Mirenën. Po ashtu, kemi propozimin përsëri Albertina Dedinca, Bardhyl Mjekiqin dhe Fitore Hashanin.

Anëtarët e Kuvendit Komunal për propozimin e parë votuan me 12 vota për dhe 7 vota kundër morën Vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve N.P.L.”Kastrioti” SH.A. me këtë përbërje: 1.Albertina Dedinca, Kryetare (LVV) 2.Bardhyl Mjekiqi, anëtar (LVV) dhe 3.Labinot Mirena, anëtar (LDK)

Pika 9 e rendit të ditës

Goran Dancetovic – I nderuari kryesues, për pikën Të ndryshme do të doja të paraqisja protestën time për keqpërdorimin e institucioneve, sipas meje për qëllime paraelektorale, pasi që ju si Komunë në fejsbuk e keni emëruar Nënkryetarin për komunitete dhe sipas meje keni ndikuar në vullnetin zgjedhor të qytetarëve. Pak po ju duket që e keni emëruar përmes fejsbukut, por i keni dhënë edhe automjet zyrtar që të vozitet nëpër vendbanimet tona, ndërsa personi për të cilin po flasim është anëtar i përhershëm i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, që sipas meje do të ishte konflikt interesi. Po shohë se këtu po e anashkaloni shumë Statutin dhe Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale. Nëse, në fejsbuk e keni emëruar Nënkryetar për komunitete, atëherë vendosni se a do të jetë anëtar i Komisionit Komunal i Zgjedhjeve, apo Nënkryetar për komunitete.

Kryesuesi – Fillimisht kisha dashtë që kur ta kërkon fjalën me prit me ua dhënë fjalën.

Kryetari - Ashtu, si tha kryesuesi është mirë me krijue një kulturë dhe me kërku fjalën qysh po e kërkojnë kolegët tu, e para. E dyta kur flasim për shkelje të ligjit është mirë secili me u nisë prej vetit dhe me pa se a ka shkelje të ligjit apo jo. Ai është përfaqësues i partisë së Nenad Rasicit dhe sigurisht se do të jetë Nënkryetar i Komunës së Obiliqit.

Goran Dancetovic – Unë u paraqita pasi që Kryesuesi e paraqiti pikën Të ndryshne dhe pyeti se a keni për të thënë dicka. Pas kësaj u lajmërova e sa i përket asaj se kujt i takon ai, i cilës parti është totalisht e parëndësishme. Unë vetëm po e përcjellë Ligjin për Vetëqverisjen Lokale, Statutin e Komunës, ku Nënkryetari për komunitete duhet të propozohet nga Kryetari i Komunës, nga ju zoti Thaci dhe të votohet nga shumica e anëtarëve të Kuvendit si dhe nga shumica e anëtarëve të komunmteteve pakicë. Duke marrë parasysh se unë dhe kolegja ime jemi të vetmit anëtarë nga komunitetet pakicë nuk kemi votuar për askend dhe as që ka ekzistuar një propozim i tillë.

Kryetari – Propozimet vijnë nga Kryetari dhe sigurisht se unë iu kisha ftue si komunitet mos me vazhdue ju me punue si subjekt politik për bandat qysh jeni mësue ju, por me punue për komunitetin. Nëse, doni bashkëpunim me komunitetin do të kemi bashkëpunim, por nëse nuk doni dhe vazhdoni me kokën e Beogradit me punue në Obiliq, e keni gabim. Prandaj, ju bëjë thirrje publike me i lënë udhëheqjet e banditave dhe me ardhë me bashkëpunue me institucione për hir të qytetarëve serbë, për hir të atyre që kanë nevojë për dorën e institucioneve. Ti e din shumë mirë për çka po flasë unë, prandaj po të them ty publikisht duhet me i lënë komandat e Serbisë në Obiliq. Këtu, në Kuvendin e Komunës së Obiliqit ka institucione të Republikës së Kosovës. Prandaj, ju kisha lutë edhe një herë ju 2 me bashkëpunue si përfaqësues të komunitetit serbë me institucionin e Komunës së Obiliqit.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Kryesues, të lutem duhet të sigurohet përkthimi për një pjesë të grupit sepse ne po e kuptojmë vetëm Kryetarin, por nuk po dijmë se çka po flasin ata.

Kryesuesi – Kjo pikë e rendit të ditës nuk ka mundësi me pasë 3 herë kundër replika.

Në fund në emër të grupit të LVV-së, dhe në emrin tim si kryesues i Kuvendit Komunal ju uroj të gjithëve Vitin e Ri 2026 dhe të gjitha të mirat.

Mbledhja përfundoi në ora 11:50'

Zyrtare e lartë për punë të KK

Azize Zeneli



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Sami Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIČ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilič – Municipality Assembly Obiliq

IZVOD IZ ZAPISNIKA

Sa vanredne sednice Skupštine Opštine, održane dana 30.12.2025. godine, u 11:00 časova, u sali Skupštine Opštine

Prisutni sledeći odbornici: Albanë Shillova Shalaku (LVV), Arbenita Pllana (LVV), Bardhyl Mjekiçi (LVV), Burim Ismaili (LVV), Fitim Grajçevci (LVV), Fjolla Nasufi (LVV), Lendita Krasniqi (LVV), Mervete Shala (LVV), Sami Ahmeti (LVV), Abdyrrahman Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Enver Gashi (LDK), Fidan Ahmeti (LDK), Fitore Hashani (LDK), Labinot Mirena (LDK), Linda Bekteshi (LDK), Muhamet Preniqi (LDK), Vlora Mjekiçi Kabashi (LDK), Biljana Spasić (SL), Goran Dančetočić (SL) i Dorentina Mustafa (AAK).

Ostali prisutni: predsednik Opštine Halil Thaqi, zamenik predsednika Opštine Berat Gashi, opštinski, predstavnici KFOR-a, predstavnici OEBS-a i opštinski službenici.

Sednicu je vodio Sami Ahmeti, predsedavajući, koji je, nakon što je konstatovao da postoji kvorum, započeo sednicu sledećim:

DNEVNIM REDOM

1. Obrazloženje za odsustvo
2. Usvajanje izvoda iz zapisnika sa prethodnih sednica
3. Formiranje Radne grupe za izradu Plana rada Skupštine Opštinske za 2026. godinu
4. Razmatranje i usvajanje Opšte liste nepokretne imovine Opštine i Posebne liste nepokretne imovine Opštine koja se planira dati na dugoročno korišćenje za narednu 2026. godinu
5. Razmatranje Izveštaja o sprovođenju Plana integriteta
6. Formiranje Komiteta za politiku i finansije
7. Formiranje Komiteta za zajednice
8. Formiranje Opštinske komisije akcionara J.P.L. „Kastrioti“ A.D.
9. Razno

Presedavajući je otvorio sednicu i pozvao dva nova člana Skupštine Opštine g. Burima Ismailija (LVV) i gđu Arbenitu Pllanu (LVV), da položu zakletvu, što su i učinili, čime su ispunili pravo na dužnost članova skupštine Opštine.

Nakon toga, presedavajući je upoznao prisutne sa dnevnim redom, koji je usvojen jednoglasno.

Tačka 1 dnevnog reda

Svi članovi Skupštine Opštine bili su prisutni.

Tačka 2 dnevnog reda

Izvodi iz zapisnika sa prethodnih sednica usvojeni su sa 19 glasova .

Tačka 3 dnevnog reda

Presedavajući – Izneo je formiranje Radne grupe za izradu Plana rada skupštine Opštine za 2026. godinu. Ovo je plan koji se izrađuje svake godine unapred za narednu godinu i Radna grupa može se sastojati od 3 člana, ali na vaš zahtev može imati i više članova.

Fjolla Nasufi – Predlaže gđu Lenditu Krasniqi za člana Radne grupe.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Na osnovu Poslovnika o radu skupštine Opštine Obilić, br. I-95 od 29.06.2018. godine, konkretno člana 64 stav 5, obaveštavam vas da grupu odbornika LDK-a predstavlja se od moje strane Vlora Mjekiqi Kabashi. Što se tiče formiranja Radne grupe za izradu Plana rada Opštinske skupštine za 2026. godinu, predlažem sebe.

Fjolla Nasufi – Predlaže g. Burima Ismailija za člana Radne grupe.

Nakon rasprave, odbornici Opštinske skupštine sa 19 glasova doneli Odluku o formiranju Radne grupe za izradu Plana rada skupštine Opštine za 2026. godinu u sledećem sastavu: 1. Lendita Krasniqi 2. Vlora Mjekiqi Kabashi 3. Burim Ismaili.

Tačka 4 dnevnog reda

Presedavajući – Izneo je razmatranje i usvajanje Opšte liste nepokretne imovine Opštine i Posebne liste nepokretne imovine Opštine koja se planira dati na dugoročno korišćenje za 2026. godinu.

Fjolla Nasufi – Imajući u vidu da je ovo godišnji proces, mi prihvatamo izneti predlog.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Mi smo za usvajanje ove liste, jer je to predviđeno zakonom, ali ako postoji mogućnost, dajemo malu preporuku: u aktu se navodi „Opštinska komisija“, a bilo bi dobro da se, kao i ranije, navede odluka, broj protokola i datum, kako bismo znali iz koje Direkcije je komisija i kada je odobrena. U principu, mi smo za.

Goran Dančetović – Mi nismo dobili listu nepokretnosti u materijalu, kao ni zapisnik sa poslednje sednice, zbog čega smo bili uzdržani.

Nakon rasprave, odbornici skupštine Opštine sa 19 glasova doneli Odluku o usvajanju Opšte liste nepokretne imovine Opštine i Posebne liste nepokretne imovine Opštine koja se planira dati na dugoročno korišćenje za 2026. godinu.

Tačka 5 dnevnog reda

Presedavajući – Izneo je razmatranje Izveštaja o sprovođenju Plana integriteta. Ovo je redovan plan koji

izrađuje nadležna kancelarija. S obzirom na to da izveštaj nije dovoljno tretiran, nema potrebe da se o njemu glasa.

Fjolla Nasufi – Trenutno nemamo komentara u vezi sa ovom tačkom.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Ni mi kao grupa nemamo komentara, iako je presedavajući možda trebalo prvo nama dati reč, u skladu sa brojem odbornika u Skupštini.

Pred\sedavajući – Poštovana gđo Vlora, u vezi sa ovim pitanjem tražio sam i tumačenje od MALS-a. Imajući u vidu da se ovo pitanje meri brojem mesta u Skupštini, to je u našoj diskreciji i s obzirom na to da uvek dajem prednost desnoj strani, ovog puta ćemo postupiti na ovakav način.

Tačka 6 dnevnog reda

Presedavajući – Na osnovu Zakona o lokalnoj samoupravi, Statuta Opštine, Poslovnika i Administrativnog uputstva MALS-a, Komitet za politiku i finansije u našoj Opštini će se sastojati od 7 članova. Imajući u vidu da LVV ima 9 odbornika u Skupštini, biće predstavljena presedavajućim i sa još dva člana, LDK će takođe biti predstavljena sa 3 člana, a smatram da i AAK treba da bude predstavljen sa jednim članom. Imajući u vidu da želimo sveobuhvatnost, a u drugom odboru imaćemo mogućnost zastupiti i grupu Srpske liste.

Fjolla Nasufi – Predlaže sebe i Albanë Shillova Shalaku.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Na osnovu Administrativnog uputstva MALS-a br. 05/2020 o postupku osnivanja, sastavu i nadležnostima stalnih komiteta i drugih komiteta u Opštini, konkretno člana 5 stav 2, precizira se da će politički subjekt sa najvećim brojem mesta, u zavisnosti od procenta zastupljenosti u Skupštini, biti zastupljen i u KPF. Iz dosadašnje prakse nam je dobro poznato da se u ovim komitetima predstavljaju političke grupe, a AAK nije zastupljena kao grupa, jer je poznato da grupa mora imati najmanje 3 člana. Prema tome, ne može biti predstavljena u Komitetu za politiku i finansije, jer nije politička grupa, jer ima samo jednog odbornika.

Presedavajući – Kao što smo i ranije rekli, želimo da imamo sveobuhvatnost i saglasni smo da, ukoliko takva tačka prođe glasovima odbornika Opštinske skupštine, bude usvojena, ali koji su vaši predlozi.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Moji predlozi su: Fidan Ahmeti, Vlora Mjekiqi Kabashi, Linda Bekteshi i Enver Gashi.

Abdyrrahman Krasniqi – Ispred LDK-a, ponovo predlažemo gđu Vloru Mjekiqi Kabashi, s obzirom na to da je i šefica poslaničke grupe, g. Labinot Mirenu, i sebe g. Abdyrrahmana Krasniqija, za članove Komiteta za politiku i finansije.

Goran Dančetović – Poštovani presedavajući, čuo sam vaše izlaganje od početka i mislim da je protivno članu 57. Statuta Opštine Obilić. U ovom članu se naglašava da članovi Komiteta za Politiku i Finansije treba da se biraju iz redova članova Skupštine Opštine, i da treba da oslikavaju proporciju zastupnosti političkih stranaka i rodnu zastupnost Skupštine. Znači, verovatno 30 % žena treba da bude i treba da bude od svake stranke koja ima odbornike, tako da smatram da i Srpska lista treba da ima člana u Komitetu za Politiku i Finansije, a ne odborničke grupe sa 3. U tom članu se ne spominju odborničke grupe.

Presedavajući – I u prethodnoj tački sam rekao da želimo da svaka poslanička grupa u Skupštini bude uključena, dok će u drugom komitetu i Srpska lista imati svog predstavnika.

Dorentina Mustafa – Predlažem sebe, Dorentinu Mustafu, s obzirom na to da sam jedina predstavница Alijanse u Skupštini.

Enver Gashi – Predsedavajući, mi kao poslanička grupa, kao i sve ostale poslaničke grupe, imamo šefa grupe koji predstavlja celu grupu. Imam ozbiljnu primedbu, jer vi niste novi – bili ste u prethodnom mandatu ovde – i kada se šef LVV-a, predlaže kandidate, za mene je to u skladu sa Skupštinom, zakonom i pravilima i tu se završava, a ne da se dodatno pita bilo ko. Isto važi i za LDK – imamo šefa grupe i on daje predloge u skladu sa zakonom i Poslovnikom. Ako se sada pita svaki pojedinačni odbornik, onda ulazimo u dogovore. Međutim, postoje pravila i zakon, molim vas da ih primenjujete.

Predsedavajući – U početku ste dali više predloga nego što je dozvoljeno, međutim član 70 Poslovnika o radu Skupštine Opštine, stavovi 1, 2, 3, 4 i 5, pojašnjavaju da postoji mogućnost davanja i većeg broja predloga. U slučaju da ima više predloga, oni se stavljaju na glasanje i time je postupak ispravan. Ipak, u prvoj fazi ste dali četiri predloga i smatram da se jedan od njih mora povući, s obzirom na to ovo je I sprovedenje uputstva MALS-a. Stoga, koji od predloga smatrate da treba povući?

Vlora Mjekiqi Kabashi – U tom slučaju, povlači se predlog g. Envera Gashija.

Predsedavajući – Ispred LVV-a, pored mene kao predsedavajućeg, predloženi su Fjolla Nasufi i Albanë Shillova Shalaku, dok su ispred LDK-a predloženi Vlora Mjekiqi Kabashi, Fidan Ahmeti i Linda Bekteshi, a ispred Alijanse, Dorentina Mustafa.

Nakon rasprave, odbornici skupštine Opštine su glasali o prvom predlogu za formiranje Komiteta za politiku i finansije, koji je odbijen sa 7 glasova za i 12 glasova protiv.

Predsedavajući – Na osnovu člana 70. Poslovnika o radu skupštine Opštine prelazimo na drugi predlog. Ispred LVV-a, da li ima promene u imenima?

Fjolla Nasufi – Nema promena u imenima.

Predsedavajući – U tom slučaju, glasamo o drugom predlogu: ispred LVV-a – Sami Ahmeti, Fjolla Nasufi i Albanë Shillova Shalaku; ispred LDK-a – Vlora Mjekiqi Kabashi, Labinot Mirena i Abdyrrahman Krasniqi; te ispred Alijanse – Dorentina Mustafa.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Predsedavajući, molim vas.

Nakon rasprave, odbornici skupštine Opštine o drugom predlogu usvojili sa 12 glasova, 7 protiv i 1 uzdržanim glasom, te doneli Odluku o formiranju Komiteta za politiku i finansije u sledećem sastavu:

1. Sami Ahmeti, predsedavajući (LVV),
2. Fjolla Nasufi, član (LVV),
3. Albanë Shillova Shalaku, član (LVV),
4. Vlora Mjekiqi Kabashi, član (LDK),
5. Labinot Mirena, član (LDK),
6. Abdyrrahman Krasniqi, član (LDK),
7. Dorentina Mustafa, član (AAK)

Goran Dančetović – Gospodine predsedavajući, još jednom mi ćemo svoja prava pretražiti ispred Ministarstvo Lokalne Samouprave, jer smatramo da ste prekršili član 57.

Enver Gashi – Šef poslaničke grupe predstavlja celu grupu i rekao sam: ostavite se dogovora, jer ste u velikoj zabludi. Pročitajte zakon – da jedan odbornik ima uticaj zbog toga što ste s njim pravili dogovor, to je sramota. Mi ćemo podneti ozbiljnu žalbu, jer se ova Skupština javno prenosi i građani mogu da vide šta zaista radite – velika sramota; takvu sramotu ne mogu da vam prećutim.

Tačka 7 dnevnog reda

Presedavajući – Na redu formiranje Komiteta za zajednice i u skladu sa zakonom, ovaj komitet se sastoji od 9 članova, od kojih 3 bira skupština Opštinska. LVV će imati jednog člana, LDK jednog člana i Srpska lista jednog člana.

Fjolla Nasufi – Predlaže gđu Mervete Shalu za člana Odbora za zajednice.

Vlora Mjekiqi Kabashi – Poštovani presedavajući, iako vrlo dobro znamo da prethodna tačka nije bila u skladu sa pravilima, jer sam kao šefica grupe iznela svoje predloge, ali ste vi, naravno, pobedili glasanjem. Ipak, bez obzira na to, za Komitet za zajednice predlažem g. Muhameta Preniqija.

Goran Dančetović – Predlaže gđu Biljanu Spasić.

Nakon predloga, odbornici Opštinske skupštine su sa 21 glasova doneli Odluku o formiranju Komiteta za zajednice u sledećem sastavu: 1. Mervete Shala, članica (LVV), 2. Muhamet Preniqi, član (LDK) 3. Biljana Spasic, članica (SL).

Tačka 8 dnevnog reda

Presedavajući – Prelazimo na formiranje Opštinske komisije akcionara JLP „Kastrioti“.

Goran Dančetović – Rekli ste da Komitet za zajednice ima 9 članova i mi smo predložili 3 odbornika ispred Skupštine, sta je sa ostalih 6 članova.

Presedavajući – U skladu sa zakonom, preostali deo Komiteta za zajednice biće izabran u skladu sa članovima 8 i 9 stav 1 Administrativnog uputstva br. 05/2020, putem konkursa za zastupnost zajednica koje žive u Opštini Obilić.

Komisija akcionara sastoji se od 3 člana, od kojih je jedan član iz Izvršne vlasti, a dva člana iz skupštine Opštine

Predsednik Opštine – Predlaže gđu Albertinu Dedincu za člana Komisije.

Fjolla Nasufi – Predlaže g. Bardhyla Mjekiqija i g. Labinota Mirenu za članove Komisije.

Presedavajući – Daje na glasanje formiranje Opštinske komisije akcionara sa predloženim članovima.

Enver Gashi – Vi više podržavate dvojicu sa kojima ste pravili dogovore, i ti dogovori su već vidljivi. Sada smo i mi grupa i mi se pitamo.

Predsednik Opštine – Smirenije.

Enver Gashi – Predsedniče, sve je snimljeno i predlog je prošao, već ćemo mi snažno reagovati, jer se uopšte ne uvažava činjenica da imamo više glasova u Skupštini i da se uopšte ne poštujemo – samo se kaže „ko je za“ i time se završava.

Predsednik Opštine – Nema potrebe za svadju. Idemo mirno dalje, glas građana nas je doveo ovde; odbornici glasaju i proces ide dalje. Došli smo da unapredimo procese i moguće je da dođe do određenih proceduralnih propusta, zbog čega se izvinjavamo, jer sam i ja početnik na ovoj funkciji, a i presedavajući je početnik. Potrebno je da imamo međusobno razumevanje, da nam se ukaže na greške kako bismo ih ispravili. Za svaku žalbu nadležno je Ministarstvo administracije lokalne samouprave i tamo možete podneti žalbu, zato nemojmo ovo shvatati kao pritisak.

Presedavajući – Važno je da imamo zakon i da svako ko smatra da ima primedbe ima mogućnost da se žali.

Abdyrrahman Krasniqi – Želim da obavestim g. Envera da mi se čini da su njegove reakcije pomalo previše burne. Pre svega, mi imamo mandat građana i svako od nas ima obavezu da predstavlja građane, a ne šefove, niti da se bavimo dogovorima. Ako on misli i ako je tokom svoje karijere bio naviknut da pravi dogovore i da u svakom trenutku pitamo g. Envera, ja ga samo obavestavam da je on danas u penziji, te neka ima razumevanja i neka počne da se demokratizuje, da razume i drugačija mišljenja. Mi smo ovde zbog interesa građana, preduzeti aktivnosti u interesu građana i razvoja Opštine Obilić, dok on za to nema razumevanja.

Enver Gashi – Poštovani, dogovori se vide, vide se komiteti, vide se akcionari, a mi nismo ni slepi niti gluvi, ali ono što je vidljivo ne zahteva dodatno objašnjenje. Međutim, u svakoj demokratiji šef grupe se upravo zato bira – i on ne iznosi samo svoje lično mišljenje, već stav cele grupe. I sada, šta dalje?

Vlora Mjekiqi Kabashi – Poštovani predsedavajući, vi možete glasanjem da usvojite svoje predloge, ali nam ne možete uskratiti pravo na predlaganje, jer ni mi vama to pravo nismo uskratili. Dakle, imamo pravo da predlažemo i o svemu se mora odlučivati glasanjem.

Presedavajući – I pre četiri godine se postupalo na isti način, odnosno predlozi su dolazili isključivo od strane Izvršne vlasti. U svakom slučaju, vi možete dati svoj predlog i mi ćemo ga dati na glasanje. Koji je vaš predlog za ovo preduzeće?

Vlora Mjekiqi Kabashi – Što se tiče formiranja Opštinske komisije akcionara J.P.L. „Kastrioti“ A.D., mi predlažemo gđu Fitore Hashani.

Presedavajući – Imamo dva predloga: prvi predlog je Albertina Dedinca, Bardhyl Mjekiqi i Labinot Mirena. Takođe, imamo i drugi predlog: Albertina Dedinca, Bardhyl Mjekiqi i Fitore Hashani. Odbornici skupštine Opštine su za prvi predlog glasali sa 12 glasova za i 7 protiv, te doneli Odluku o formiranju Opštinske komisije akcionara J.P.L. „Kastrioti“ A.D. u sledećem sastavu: 1. Albertina Dedinca, predsednica (LVV), 2. Bardhyl Mjekiqi, član (LVV), 3. Labinot Mirena, član (LDK).

Tačka 9 dnevnog reda

Goran Dančetović – Poštovani predsedavajući, pod tačkom Razno hteo bih prvo da ulažem protest za zloupotrebu institucija, po meni predizborne svrhe, pošto ste vi kao Opština na fejsbuku imenovali Potpredsednika za zajednice, i na taj način po meni ste uticali na izbornu volju građana. Malo je bilo što je imenovan na fejsbuku, nego ste mu dali i službeni auto da se vozi po našim mestima, a lice o kome se radi je stalni član Opštinske Izborne Komisije, što po meni bi bilo sukob interesa koji je Potpredsednik Opštine. Pošto vidim da ovde dosta zaobilazite Statut i Zakon Lokalne Samouprave, ako ste po fejsbuku imenovali Potpredsednika za zajednice, onda odlučite da li će da bude član Opštinske Izborne Komisije ili Potpredsednik za zajednice.

Presedavajući: prvo, kada tražite reč, sačekajte da vam se da reč za diskusiju.

Predsednik opštine: Tako je, kao što je rekao predsedavajući, dobro je stvoriti kulturu i tražiti reč onako kako to rade vaši kolege. Drugo, kada govorimo o kršenju zakona, dobro je da svako počne od sebe i vidi da li postoji kršenje zakona ili ne. On je predstavnik stranke Nenada Rasića i sigurno će biti zamenik predsednika Opštine Obilić.

Goran Dančetović – Ja sam se javio zato što je predsedavajući rekao tačka Razno, jeli imate nešto da kažete. Nakon toga sam se ja javio, a sto se tiče toga čiji je on predlog i kojoj stranci pripada totalno je

nebitno. Ja samo pratim Zakon o Lokalnoj Samoupravi, Statut Opštine, gde zamenik Gradonačelnika treba da bude predložen od Gradonačelnika, od vas gospodine Tači, a izglasano od većine odbornika i od većine odbornika koje dolazi iz manjinskih zajednica, sobzirom da smo ja i koleginica jedini odbornici iz manjinskih zajednica nismo glasali za nikog, niti je taj predlog bio.

Predsednik: Predlozi dolaze od predsednika i sigurno ja bih vas pozvao, kao zajednicu, da ne nastavite da radite kao politički subjekti za bande, kako ste navikli, već da radite u korist zajednice. Ako želite saradnju sa zajednicom, imaćemo saradnju, ali ako ne želite i nastavite da radite po nalogu Beograda u Obiliću, grešite. Zato vas javno pozivam da ostavite vođe bandi i da počnete da sarađujete sa institucijama radi dobrobiti srpskih građana, za dobro onih kojima je potrebna pomoć institucija. Ti veoma dobro znaš o čemu govorim, zato ti javno kažem da treba da ostavite komande Srbije u Obiliću. Ovde, u Skupštini Opštine Obilić, postoje institucije Republike Kosovo. Zato vas još jednom molim, vas dvoje, da sarađujete kao predstavnici srpske zajednice sa institucijama Opštine Obilić.

Vlora Mjekiqi Kabashi: Predsedniče, molim vas da se obezbedi prevod za deo grupe, jer mi razumemo samo predsednika, ali ne znamo šta drugi govore.

Presedavajući: Za ova tačku dnevnog reda ne možete dobiti tri puta protiv repliku. Na kraju, u ime grupe LVV i u svoje ime kao predsednika Skupštine opštine, želim svima srećnu Novu 2026. godinu i sve najbolje.

Sastanak je završen u 11:50 časova.

Viši službenik za posao SO


Azize Zeneli

